

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PRITECH Automotive” sh.p.k.**

Sot në datën 05.02.2024 bazuar në ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” ortaku:

Mirela Osoja, e datëlindjes 19.07.1968, lindur në Lushnje dhe banuese në Tiranë, me nr. personal G85719101C, vendosi themelimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar: **“PRITECH Automotive” sh.p.k.**

NENI 1

Shoqëria me Përgjegjësi të kufizuar quhet **“PRITECH Automotive” sh.p.k.** dhe e ka selinë në adresën Tiranë, Nj. 7, Rr. Dritan Hoxha 137, kati i dytë, 1000.

NENI 2

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

“Të gjitha veprimtaritë dhe shërbimet, pa asnjë kufizim, që ligji ju lejon shoqërive tregtare.

Tregti me shumicë dhe me pakicë.

Import dhe eksport, shitje me shumicë e pakicë, mallrash dhe prodhimesh të ndryshme, mjeteve dhe automjeteve të ndryshme me dhe pa motor të të gjitha llojeve e kategorive, për transport udhëtarësh, mallrash, qofshin mjete rrugore, mjete lundruese, apo mjete fluturuese, etj., si dhe mjeteve të tjera të veçanta, për qëllime dhe funksione të caktuara.

Import dhe eksport, shitje me shumicë e pakicë, automjeteve, veglash, pjesësh këmbimi, nyjesh, pajisjesh, aksesorësh automjeteve, agregatesh që kanë të bëjnë me mjete motorike dhe jo motorike, të të gjitha llojeve dhe markave, vajrash lubrifikante, gomash dhe karburantesh.

Prodhim, përshtatje, ndryshim konstruktiv dhe kryerje e shërbimeve dhe riparimeve të përgjithshme apo të specializuara e/për të gjitha llojet e mjeteve dhe automjeteve rrugore, lundruese, e fluturuese, etj., si dhe për mjetet e tjera të veçanta, për qëllime dhe funksione të caktuara.

Ndryshime konstruktive të mjeteve dhe automjeteve të të gjitha llojeve, që mund të ndryshojnë ose jo kategorizimin e tij, përshtatje dhe modifikime të pjesëshme ose të plota të shasisë, të karrocërisë, ose të kabinës, të sistemit të djegies dhe injeksionit, të sistemit të drejtimit, të transmisionit, të tërheqjes apo shtytjes, të sistemit të frenimit, të sistemit të amortizimit, të sistemit elektrik e të motorit, apo të të gjithë mjetit ose automjetit në tërësi. Përshtatje, modifikime konstruktive dhe shndërrime të automjeteve me djegie të brendshme, në automjete hibride apo



plotësisht elektrike, etj., montim dhe vendosje pajisjesh, impiantesh e aksesorësh shtesë.

Prodhim mjetesh, automjetesh dhe pajisjesh, pjesësh, agregatesh dhe aksesorësh, për mjete dhe automjete me dhe/ose pa motor.

Kontroll teknik dhe certifikim i të gjitha llojeve të ndryshimeve konstruktive, apo shndërrimeve të lejuara me ligj, të mjeteve dhe automjeteve.

NENI 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“PRITECH Automotive” sh.p.k.** do të jetë pa afat.

NENI 4

Kapitali themelues i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë, i shprehur në 1 kuotë me vlerë 100,000 lekë, i kontribuar nga ortaku:

MIRELA OSOJA **1 kuotë me vlerë 100,000 Lekë.**

Ky kapital mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit që do të marrë ortaku.

NENI 5

Administrator i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“PRITECH Automotive” sh.p.k.**, do të jetë **MIRELA OSOJA**, e datëlindjes 19.07.1968, lindur në Lushnje, dhe banuese në Tiranë, me nr personal G85719101C, për një periudhë 5 vjeçare.

NENI 6

Administratori i shoqërisë së lartpërmendur, është i veshur me të gjitha atributet për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, pa asnjë përjashtim dhe kufizim. Ai ka mundësi të përpilojë të gjitha aktet që konsiderohen të nevojshme për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Ai ka të drejtë të blejë dhe të këmbëjë pasuri, të lidhet me shoqëri të tjera. Ai kryen çdo lloj veprimi pranë të gjitha zyrave shtetërore dhe private që kanë të bëjnë me garancitë dhe veprimet hipotekore.

Të gjitha këto attribute do të shoqërohen rast pas rasti me autorizim të veçantë nga ana e ortakut të vetëm dhe vetëm në këtë mënyrë veprimet e administratorit marrin fuqi ligjore.



NENI 7

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti përveç urdhërave të veçanta që jepen nga ortakut i vetëm. Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël i shoqërisë me rezultatin ekonomik, fitim-humbje, bazuar në ligjet dhe rregullat e mbajtjes së kontabilitetit nga shoqëritë private të përcaktuara nga organet kompetente të sistemit fiskal.

Bilanci kontabël miratohet nga ortakut i vetëm i shoqërisë. Me miratimin e bilancit kontabël vjetor, ortakut i vetëm vendos për krijimin e fondeve të ndryshme për shoqërinë si atë të akumulimit, të rezervës, etj.

NENI 8

Administratori ka të drejtë të hyjë në marrëdhënie ekonomiko-financiare me autorizim të ortakut të vetëm, me persona fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, mbi bazën e kontratave, bazuar në legjislacionin Shqiptar.

NENI 9

Në marrëdhënie financiare shoqëria vepron me monedhën vendase, Lekun. Ajo ka të drejtë të përdorë edhe valutë të huaj konform legjislacionit në fuqi.

NENI 10

Marrëdhëniet e shoqërisë me personelin e saj do të rregullohen mbi bazën e legjislacionit të punës. Shoqëria ka të drejtë të pushojë çdo punonjës të personelit nga puna për shkak të indisiplinimit ose paaftësisë profesionale duke kërkuar gjithashtu dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar shoqërisë nga punonjësit për faj të tyre.

NENI 11


Në rast prishjeje të shoqërisë, ortakut i vetëm cakton një likuidator, i cili në fund të likuidimit paraqet bilancin e likuidimit.

NENI 12

Ky Akt Themelimi hartohet në pesë kopje, secila me vlerë të barabartë.

ORTAKU I VETËM

MIRELA OSOJA

Handwritten signature of Mirela Osoja in blue ink, written in a cursive style.